



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.24.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
VUSHTRRIË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga, Ajtene Llapashtica, Udhëheqës Ekipi dhe Ylber Sadiku, anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Zukë Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
5 Qeverisja e mirë.....	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	31
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	33
Shtojca III: Letër konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e stafit të komunës, përgjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Shpenzimet për subvencione në vlerë 276,246€ ishin buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Vlera e pasurisë e shpalosur në regjistrat e pasurisë dhe pasqyrat financiare nuk ishte e saktë.

Për më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Theksimi i çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar planifikimin dhe klasifikimin e duhur të shpenzimeve, si dhe regjistrat jo të plotë të pasurisë, përfshirë edhe prezantimin e tyre në pasqyrat financiare.



Kryetari, duhet t'i analizojë arsyet për theksimin e çështjes në 2017 dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen me qëllim të përmirësimit të raportimit. Deklarata për pasqyrat financiare të vitit 2018 duhet të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih kapitullin 2).

Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në disa fusha, dobësi evidente janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare, kryesisht të prokurimi, përfshirë menaxhimin e kontratave.



Kryetari, duhet të kryej një rishikim të procesit të prokurimit si dhe të forcoj kontrollet aty ku dështimet janë identifikuar në procese (shih çështjet 2 deri 18).

Rekomandimet e viteve paraprake nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Kryetari, duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që procesi i zbatimit të rekomandimeve të viteve paraprake adresohen në mënyrë aktive (shih çështjen 19).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Komiteti i auditimit nuk ka arritur të kontribuoj mjaftueshëm në mbështetjen e auditimit të brendshëm.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies, raportimit menaxherial dhe menaxhimit të rreziqeve, të mbështetur nga një komitet i auditimit më efektiv (shih çështjet 20 - 21).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;

Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;

Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe

Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e komunës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Vushtrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna, për vitin 2017 kishte planifikuar gjithsej 107 projekte për investime kapitale të cilat i kishte përfshirë në Programin e Investimeve Publike (PIP). Prej tyre, tetë projekte¹ në vlerë 276,246€, ishin buxhetuar dhe realizuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale, megjithëse i përkasin natyrës së subvencioneve (projekte të cilat nuk e plotësonin kriterin e përvetësimit të pasurisë për komunën e Vushtrrisë). Sipas zyrtarëve të komunës, arsyeja qëndron për faktin se ndarjet buxhetore në kategorinë e subvencioneve² ishin tejet të ulëta në raport me nevojat për to; dhe
- Regjistrat e pasurisë nuk ishin të saktë. Tri pagesa me vlerë 85,896€ (pasuritë e blera mbi 1,000) nuk figurojnë në regjistrin e SIMFK-së, për të cilat është nënvlerësuar regjistri i pasurive. Në anën tjetër nga i njëjti regjistrer nuk ishte shlyer toka e cila ishte shpronësuar nga MMPH³ me vlerë prej 1,398€. Me tutje, sistemi i E-pasurisë (pasuritë nën 1,000€) nuk prezanton gjendjen e saktë. Nga 18 mostra të testuara, 13 prej tyre në vlerë 11,337€ nuk ishin regjistruar, duke nënvlerësuar pasurinë për këtë vlerë. Po ashtu, problemet e identifikuar në raportin e vitit të kaluar për llogaritjen e zhvlerësimit të pasurisë në sistemin E-pasuria janë ende prezente.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

¹ Projektet, kryesisht ishin të natyrës së subvencionimit apo projekte bashkëfinancimi për ndihmë qytetarëve, në sferën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.

² Sipas librit të buxhetit 2017: Subvencionet ishin në vlerë 182,914€, ndërsa investimet kapitale 4,383,326€.

³ Të hyrat nga toka e shpronësuar nga MMPH ishin me vlerë 15,767€, kjo tokë në regjistrat e SIMFK-së figuron me vlerë 1,398€.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalesjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve; dhe
- Kërkesat për raportimet tremujore.

PVF-të marrë si tërësi janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF. Megjithëse, përpos çështjeve të theksuara në opinionin e auditimit, ne kemi identifikuar se te shpalesjet e të arkëtueshmeve saldot fillestare janë nënvlerësuar për 29,724€ (taksat në biznes 23,652€ dhe shfrytëzimi i pronës publike 6,072€).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura ne japim rekomandimet, si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në planifikimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre në PFV.

Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin financiar janë të vendosura mirëpo nuk janë efikase për kategori të veçanta. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat, në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet në disa fusha të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë në ekzekutimin e pagesave, vonesat në përfundim të projekteve, menaxhimin me pasurinë dhe me llogaritë e arkëtueshme. Fusha me sfiduese, kryesisht mbetet fusha e prokurimit, përfshirë menaxhimin e projekteve kapitale.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁴	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	15,902,353	16,398,367	14,936,159	14,709,133	14,915,393
Granti i Qeverisë -Buxheti	13,585,618	13,472,692	13,244,927	13,124,948	13,118,126
Të hyrat vetjake ⁵	2,316,735	2,316,735	1,286,793	1,073,849	1,050,239
Të bartura nga viti paraprak ⁶		519,541	324,723	294,794	384,808
Donacionet e brendshme	-	63,278	53,767	45,192	76,536
Donacionet e jashtme	-	26,121	25,949	170,350	285,684

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 496,014€. Përshtatjet buxhetore kanë ndodhur si rezultat i të hyrave vetjake të bartura në vlerë prej 519,541€, grandeve të donatorëve 65,644€ si dhe vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore në fund vit në vlerë prej 112,926€.

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake

⁶ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

Gjithashtu te buxheti final dhe shpenzimi është përfshirë edhe një pagesë direkte në vlerë prej 23,755€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final me një rënie prej 4% krahasuar me vitin 2016.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	15,902,353	16,398,367	14,936,159	14,709,133	14,915,393
Pagat dhe Mëditjet	9,532,316	9,464,391	9,450,294	9,520,179	9,376,098
Mallrat dhe Shërbimet	1,562,755	1,613,307	1,397,121	1,444,943	1,374,075
Shërbimet komunale	241,042	252,502	232,614	221,223	237,409
Subvencionet dhe Transferet	182,914	188,107	187,426	190,578	211,079
Investimet Kapitale	4,383,326	4,880,060 ⁷	3,668,704	3,332,210	3,716,736

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 67,924€. Fillimisht ishte rritur me të hyrat vetjake të bartura me vlerë 9,831€, mirëpo me vendimin e Qeverisë për kursime buxhetore në fund të vitit buxheti ishte reduktuar për 77,756€;
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti final ishte rritë për 50,552€. Fillimisht buxheti ishte rritur me të hyrat vetjake të bartura për 70,635€, dhe grantet e donatorëve për 1,203€, mirëpo me pas me vendimin e Qeverisë për kursime buxhetore në fund vit ishte reduktuar për 21,286€;
- Buxheti final te shërbimet komunale ishte rritur nga të hyrat vetanake të bartura për 11,460€;
- Buxheti final te subvencionet ishte rritë për 5,193€ (nga të hyrat vetanake 3,000€ dhe nga grantet e donatorëve 2,193€); dhe
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 496,734€. Fillimisht ishte rritë nga të hyrat vetanake prej 424,614€ si dhe grantet e donatorëve për 62,247€, ndërsa në fund të vitit me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore ishin reduktuar 13,884€.

Në anën tjetër, në bazë të vendimeve gjyqësore janë ekzekutuar 56 pagesa në vlerë 151,970€, ndërsa një pagesë direkte nga Thesari (neni 39.2) ishte prej 52,675€. Vendimet gjyqësore kryesisht kishin të bëjnë me pagesat e dala nga marrëveshja kolektive për pagesë të tri pagave jubilarë të punonjësve të arsimit, dhe tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit.

⁷ Në këtë vlerë përfshihet edhe buxheti i një pagese direkte në vlerë prej 23,755.98€ e cila reflekton edhe te shpenzimi

Çështja 2 – Nivel i ulët i realizimit të investimet kapitale dhe keq-klasifikimi i shpenzimeve

E gjetura Pavarësisht rritjes së buxhetit të investimet kapitale, vetëm 75% e tyre ishin realizuar. Realizimi i ulët lidhet kryesisht me vonesat në realizimin e projekteve, si dhe mos realizimin e procedurave për 10 projekte të parapara në Programin për Investime Publike (PIP).

Niveli i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale ishte si pasojë e mungesës së analizave në baza të rregullta lidhur me ecuritë buxhetore kundrejt projekteve të synuara.

Me tutje, pagesa prej 19,900€ ishte bërë nga buxheti për mallra dhe shërbime, ndonëse natyra e tyre kishte të bënte me subvencione. Pagesat ishin bërë bazuar në marrëveshjen me “Islamic Relief Wold Wide” për ofrimin e shërbimeve shëndetësore pa pagesë me rastin e vizitave mjekësore nga ana e stafit shëndetësorë.

Rreziku Ekzekutimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, e kjo do të ndikoj në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit me kohë dhe në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Me tutje, duhet të sigurojë se planifikimi dhe buxhetimi i shpenzimeve bëhet konform natyrës së tyre, bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin në vlerë 2,021,801€. Burimi i realizimit të tyre ishte nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu komuna kishte edhe të hyra indirekte nga gjobat në trafik 53,754€, dënimet e gjykatës 5,115€ dhe gjobat nga pyjet 2,264€. Të hyrat nga grantet e donatorëve për këtë periudhë ishin 42,045€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,316,735	2,316,735	2,021,801 ⁸	1,428,884	1,400,925
Totali	2,316,735	2,316,735	2,021,801	1,428,884	1,400,925

Komuna, kishte performancë të mirë (87%) në realizimin e të hyrave të planifikuara për vitin 2017. Kjo performancë vërehet edhe nëse bëhet një krahasim me vitet e mëhershme siç janë prezantuar në tabelë.

Megjithatë, në kontest të çështjeve procedurale, kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja 3 – Mos verifikimi i 1/3-tat të pronave nën menaxhim të komunës

- E gjetura** Sipas udhëzimit administrativ nr. 03/2011 neni 13 - verifikimi në teren i pronave, zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar që çdo vit të bëjë verifikimin në teren të 1/3-ës së pronave të regjistruara. Sipas regjistrave të zyrës komunale për tatimin në pronë janë gjithsejtë 22,716 prona të regjistruara në komunë, prej tyre janë verifikuar vetëm 1,751 prona.
- Rreziku** Mos verifikimi i 1/3-ës të pronave mund të rezultojë me informata të paplota të pronës së tatueshme aktuale, pasi nuk përfshihen ndryshimet në prona si dhe humbje potenciale financiare nga inkasimi më i ulët.
- Rekomandimi 3** Kryetari, duhet t'i analizojë pengesat në zbatimin e kësaj kërkesë dhe të identifikojë mënyra për adresimin e rekomandimit në këtë fushë. Në këtë aspekt, duhet të siguroj mekanizma efektiv për verifikimin e kuotës së përcaktuar prej 1/3-ës së pronave për tatimin në pronë, siç kërkohet me udhëzimin administrativ.

⁸ Kjo shifër nuk përfshin, gjobat, dënimet, e as grantet e donatorëve.

Çështja 4 – Menaxhimi i të dhënave të tatimit në pronë.

E gjetura Testimi i pagesave për dy fatura kishte të bënte për tatimin e ngarkuar për dy objektet me vlerë 9,676€ dhe 7,363€. Këto objekte kanë qenë nën menaxhim të AKP deri në vitin 2005, kur edhe janë shitur. Në bazë të vendimit të AKP-së të datës 15.04.2013, përfituesi i ri është edhe tatimpagues i cili i bartë të drejtat dhe përgjegjësit për pagesën e tatimit në pronë. Më datë 29.08.2017, AKP ka paguar borxhin deri me rastin e privatizimit⁹, ndërsa përfituesi i ri ishte regjistruar si tatim pagues tek në vitin 2006. Borxhi i mbetur për muajt pas momentit të privatizimit si dhe kamata dhe dënimi i gjeneruar në mënyrë automatike nga ana e sistemit PROTAX kishte arritur vlerën prej 7,010€ (data e faturës aktuale 27.02.2018).

Baza tatimore para privatizimit për këto dy objekte ishte 12,096m² dhe 9,072m² ndërsa me rastin e privatizimit, dy objektet janë fuzionuar në një bazë tatimore prej 12,966m², që tregon një masë për 8,202m² më pak. Nga zyrtarët komunal nuk është ofruar dëshmi kadastrale për këto ndryshime me arsyetimin se nuk janë bërë regjistrimet e objekteve në zyrën e kadastrit.

Rreziku Kontrollat e dobëta në menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë duke mos e ruajtur konsistencën në bazën e tatimit ka për rrezik dëmtim të buxhetit me ulje në inkasimin e të hyrave. Vendimet e vonuara të ndërmarra për pagesën e borxhit nga ana e AKP reflektojnë krijimin e obligimeve fiktive.

Rekomandimi 4 Kryetari, duhet të sigurojë kontrole efikase në departamentin e tatimit në pronë, konkretisht në menaxhimin e të dhënave në sistemin Protax. Gjithashtu edhe verifikimi i pronave në teren do të mundësonte që të dhënat të azhurnohen në bazë të gjendjes faktike në teren.

⁹ Privatizimi ishte kryer me datë 12 Maj 2005.

Çështja 5 – Standardet e dyfishta me rastin e kalkulimit të taksave për leje ndërtimore.

- E gjetura** Drejtoria e urbanizmit nuk ishte vendosur një standard për kalkulimin e taksave për leje të ndërtimit¹⁰. Ne vërejtëm se me rastin e kalkulimit së taksave, në disa raste aplikohet e në disa raste nuk aplikohet taksa e densitetit, për pjesën e hapësirave të përbashkëta në ndërtesat e banimit (para-hyrjet dhe ashensorët).
- Rreziku** Kontrollat jo adekuate dhe mungesa e procedurave të brendshme të shkruara, ndikojnë që në raste të ngjashme, të mos ketë trajtim të barabartë dhe dëmtim të palëve të cilët pajisen me leje ndërtimore, njëherit edhe dëmtimi i reputacionit të komunës.
- Rekomandimi 5** Kryetari, në bashkëpunim me drejtorinë e urbanizimit duhet që të sigurojë aplikimin e kontroleve shtesë për të siguruar se është duke u aplikuar në tërësi rregullorja për tarifa 2015. Në këtë aspekt do eliminohet mundësia e aplikimit të standardeve të dyfishta për çështjet e njëjta.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhet përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Komuna e Vushtrrisë për vitin 2017 për paga dhe mëditje kishte buxhet në vlerë prej 9,464,391€, derisa ka shpenzuar 99% të buxhetit final.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

¹⁰ Për lëshuarën e lejes së ndërtimit paguhet taksa administrative, për objekte të banimit duhet të paguhet edhe taksa e densitetit për hapësirat e banimit, sipas rregullores për tarifa 2015.

3.4 Menaxhimi i personelit

Çështjet e evidentuara që kanë të bëjnë me dobësitë në menaxhimin dhe organizimin e personelit i paraqesim në vijim:

Çështja 6 - Dobësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit

- E gjetura** Në procedurën e rekrutimit për pozitën “Drejtor i qendrës kulturore” nuk ishin respektuar kriteret e rekrutimit. Nuk ishte dokumentuar kriteri i obligueshëm prej katër vjet përvojë punë në udhëheqje.
- Në procedurën e rekrutimit për pozitën “Mësues klase”, kontrata për personin e angazhuar ishte lëshuar për kohe të pacaktuar, ndonëse nuk e plotësonte kriterin e përvojës së punës¹¹.
- Rreziku** Anashkalimi i kriterëve gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve ndikon në rregullsinë e procesit dhe nuk ofron siguri se është angazhuar personi i duhur.
- Rekomandimi 6** Kryetari, duhet të sigurojë se respektohen dispozitat dhe kërkesat ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit, dhe të sigurohet që vetëm kandidatët meritor kanë fituar pozitat e punës.

Çështja 7 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta për pozita të rregullta të punës

- E gjetura** Komuna, gjatë vitit 2017 ka angazhuar 18 punonjës si staf me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV). Angazhimi i tyre ishte bërë përmes procedurave të konkursit publik. Shumica e të punësuarave në këtë formë janë vendosur në pozita të rregullta të punës. Kjo ishte si pasojë e mungesës së pozitave të aprovuara në planifikimin e buxhetit.
- Rreziku** Angazhimi i stafit me MSHV për pozita të rregullta mund të rezultojë në jo efikasitet/jo efektivitet operacional duke penguar kështu arritjen e objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 7** Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.

¹¹ Sipas UA10/2015, (neni 3 paragrafi 1.2) të drejtë kontrate me kohë të pacaktuar ndër të tjera kanë vetëm mësime dhënësit të cilët kanë më shumë se një vit përvojë pune në arsim.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 1,865,809€, prej tyre ishin shpenzuar 1,629,735€ apo 87%. Këto shpenzime kryesisht përfshijnë shpenzimet komunale, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera.

Çështja 8 – Vazhdimi i kontratave publike kornizë

E gjetura Sipas Ligjit për prokurimin publik, neni 38.2 “Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më gjatë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen. Në katër raste ne identifikuam se kontratat kornizë ishin vazhduar më gjatë se periudha e përcaktuar, si:

- Kontrata kornizë “Sigurimi fizik i objekteve komunale” ishte vazhduar për tre muaj sipas kushteve të njëjta të kontratës paraprake. Vlera totale e pagesave që janë bërë bazuar në kontratën e vazhduar ishin 66,672€. Kontrata ishte vazhduar për shkak të anulimit të procedurës së prokurimit për lidhjen e kontratës së re;
- Kontrata kornizë për “Furnizim me karburante dhe vajra për automjete” ishte vazhduar për gjashtë muaj, përderisa pagesat deri në fund të vitit bazuar në kontratën e vazhduar ishin 45,427€. Kontrata ishte vazhduar për shkak të vonesave që ishin shkaktuar në procedurat e udhëhequra nga AQP për këtë kontratë;
- Kontrata “Shërbime hoteliere në bufenë komunale” ishte vazhduar për dy muaj, pagesat bazuar në kontratën e vazhduar ishin 2,202€. Vazhdimi i kontratës kishte ndodhur si pasojë e vonesave të kërkesave nga njësitë kërkuese; dhe
- Kontrata “Mirëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve të A.K. Vushtrri” ishte vazhduar për një muaj, pagesat bazuar në kontratën e vazhduar ishin 13,072€. Vazhdimi i kontratës ishte shkaktuar pasi kishte ankesa gjatë procedurave të prokurimit.

Rreziku Mos respektimi i kërkesave ligjore mund të rezultojnë me dëmtim të buxhetit me pagesa të parregullta dhe mund të rezultojnë me mungesë të buxhetit për realizimin e projekteve të parapara.

Rekomandimi 8 Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërprerë praktikrat e vazhdimit të kontratave në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit si dhe të sigurojë se janë analizuar mjaftueshëm shkaqet e rasteve të identifikuara. Njësitë kërkuese duhet të paraqesin me kohë kërkesat dhe specifikimet e sakta për llojin dhe nevojën e shërbimeve. Me tutje procedurat e tenderimit të fillojnë më kohë për të shmangur vonesat në lidhjen e kontratave.

Çështja 9 – Vonesa dhe parregullsi në liferimin dhe pranimin e mallrave

E gjetura Në dy raste, te kontrata “Furnizim me material pedagogjik për shkolla” për pagesën 9,859€ dhe te kontrata “Furnizimi me lëndë djegëse - dru për ngrohje” pagesat 30,212€ dhe 21,787€, kemi evidentuar se pranimi i mallrave bëhej pa komision, nga një person i vetëm. Po ashtu, te kontrata “Furnizimi me lëndë djegëse - dru për ngrohje” kishte vonesa në liferimin e mallrave prej katër deri në 20 ditë, përderisa nuk ishin aplikuar penale.

Në anën tjetër, fletë dërgesat janë nënshkruar nga persona që nuk ishin në komisionet pranuese të caktuar për pranimin e mallrave. Komisionet pranuese në fund hartonin një raport bazuar në fletë dërgesat individuale.

Rreziku Pranimi i mallrave nga një person është në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe rrezikon që mallrat nuk pranohen në sasinë dhe cilësinë e kontraktuar. Vonesat në liferimin e mallrave dhe shërbimeve mund të paraqesin pengesë në aktivitetet operacionale të komunës.

Rekomandimi 9 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtese në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale, nga komisionet përkatëse. Në rastet e vonesave në liferimin e mallrave dhe shërbimeve të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 188,107€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 187,426€. Subvencionet ndahen për entitete publike dhe jopublike.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,880,060€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,668,704€ apo 75%. Shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, ndërtim të shkollave, shpronësime, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit. Po ashtu, në kuadër të shpenzimeve për investime kapitale, vlera prej 122,675€ ishte realizuar për “Hartimin e projekteve” të cilat më tej nuk ju ishin bashkëngjitur projekteve konkrete për të cilat ishin hartuar.

Çështja 10 - Mungesa e projektit ekzekutiv

- E gjetura** Në 11 raste, te kontratat për punë, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutiv¹², por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Kjo kishte ndodhur për shkak të skadimit të kontratës që komuna kishte për hartimin e projekteve dhe vonesave në procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratës së re.
- Rreziku** Mungesa e hartimit të projektit ekzekutiv krijon hapësirë që projektet të cilat iniciohen vetëm me paramasë dhe parallogari të mos përmbushin kërkesat e duhura, mund të ketë vonesa në realizimin e tyre dhe si të tilla mund të kenë kosto shtesë.
- Rekomandimi 10** Kryetari, duhet të forcoj kontrollet për të siguruar se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UA i KRPP nr. 1/2014 për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë.

Çështja 11 - Mos fillimi i punëve për projektin me bashkëfinancim

- E gjetura** Komuna, kishte lidhur marrëveshje mirëkuptimi për financimin e projektit “Ndërtimin e shtatores dhe rregullimin e sheshit Hasan Prishtina” në bashkepunim me Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK), me datë 27.03.2017. Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte financimi i përbashkët i projektit me vlerat prej: AMKMK 250,000€ dhe komunës 90,000€. Projekti pritej të përfundohej në vitin 2017.
- Komuna, kishte përfunduar obligimet e saja sipas marrëveshjes, projekti i shtatores ishte përfunduar dhe ishte bërë pranimi i përkohshëm teknik, mirëpo shtatorja gjendet jashtë funksionit (e vendosur në një sallë sportive), përderisa ende pritet të filloj rregullimi i sheshit¹³ ku do të vendoset shtatorja. Mos fillimi i punëve/ngecjet në projekt për rregullimin e sheshit janë ndikuar nga komuna, pasi nuk ishte liruar hapsira/objekti ku do të ndërtohej sheshi.
- Rreziku** Mos planifikimi me kohë i rreziqeve për realizimin e projektit, vë në rrezik zbatimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, humbjen e fondeve apo mos realizimin e objektivave të komunës për realizimin e projekteve.
- Rekomandimi 11** Komuna, duhet të siguroj realizimin e projekteve sipas prioriteteve, duhet të siguroj se evitohen pengesat në realizimin e projektit dhe se do të bëj të gjitha përpjekjet që projektet të realizohen sipas marrëveshjes.

¹² Parashihet me UA-KRPP nr. 1/2014 për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë.

¹³ Ndërtimi i sheshit sipas marrëveshjes do të përfundohej nga AMKMK

Çështja 12 - Vonesat në realizimin e kontratave

E gjetura

Në rastet e mëposhtme kemi evidentuar vonesat që janë bërë gjatë realizimit të kontratave, ku afatet për realizimin e këtyre kontratave ishin përcaktuar në ditë kalendarike, si:

- Për dy projekte tri-vjeçare “Asfaltimin e rrugës Bozhlan-Vesekovc-Kurillovë” dhe “Ndërtimin e shkollave në Druar, Pantinë dhe Maxhunaj, kontratat ishin të vitit 2015. Sipas kontratës përfundimi i punëve parashihej brenda 300 respektivisht 270 ditëve kalendarike, derisa realizimi i kryerjes së punëve në teren ishte kalkuluar me ditë pune;
- Në nëntë¹⁴ raste që kanë të bëjnë me ndërtime dhe asfaltime, vonesat në realizimin e kontratave ishin duke filluar prej nëntë deri në 88 ditë vonesë kalendarike. Për më tepër në një rast është identifikuar vonesa deri në 405 ditë;
- Tek kontrata për “Furnizimin me autoambulancë për bartje të pacientëve me hemodializë” në vlerë 35,855€, furnizimi ishte realizuar me vonesë prej 15 ditë kalendarike. Po ashtu duhet theksuar se menaxheri i kontratës kishte qenë edhe anëtar i komisionit për vlerësimin e ofertave, e cila nuk përkon me kërkesat e udhëzuesit mbi prokurimin publik; dhe
- Në katër¹⁵ raste kontratat të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2017 ende nuk janë përmbyllur.

Vonesat në realizimin e kontratave kryesisht ishin për shkak të mungesës së menaxhimit adekuat nga ana e komunës, mungesës së projekteve ekzekutive, problemeve me banorët lokal për shkak të çështjeve të pa definuara pronësore, kushteve atmosferike, specifikave të punëve etj. Në asnjërin prej rasteve të lartpërmendura nuk janë aplikuar penale lidhur me vonesat në realizimin e kontratave.

¹⁴ Kontrata për: “Ndërtimin e varrezave të dëshmorëve të kombit”, projekt dy vjeçar në vlerë prej 71,342€ (56 ditë); “Asfaltimin e rrugëve lokale në Stanovci i Epërm - Gracë” në vlerë prej 108,000€ (29 ditë); “Asfaltimin e shtatë rrugëve lokale” në vlerë prej 177,000€ (22 ditë); “Ndërtimin me kubëza betoni të rrugëve lokale - faza e dytë” në vlerë prej 104,733€ (22 ditë); “Asfaltimin e rrugës lokale Zylfije Krasniqi” në vlerë prej 23,400€ (9 ditë); “Rregullimin e platove të shkollave fillore në Druar, Pantinë dhe Maxhunaj” në vlerë prej 21,858€ (88 ditë); “Rregullimin e trotuarit në rr. Isa Boletini” në vlerë prej 9,099€ (18 ditë); “Ndërtimi me kubëza betoni i trotuareve në rrugët lokale” (dt. e kontratës 08.07.2016) në vlerë prej 19,259€ (405 ditë).

¹⁵ Kontrata për: “Asfaltimin e 13 rrugëve lokale” në vlerë prej 156,815€; “Asfaltimin e shtatë rrugëve lokale” në vlerë prej 79,150€, “Renovimin e shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit” në vlerë prej 134,121€; dhe “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit Vushtrri - Gracë”.

Rreziku Lidhja e kontratave për kryerjen e punëve me ditë kalendarike, si dhe realizimi i punëve me ditë pune ka për rrezik që punët të zgjaten përtej planit të paraparë dhe zvogëlimin e mundësisë për evidentimin e vonesave në kryerjen e punëve dhe apo aplikimin të penaleve. Vonesat në realizimin e kontratave mund të rezultojnë me pengesë në aktivitetet operationale të komunës. Po ashtu, dobësitë në menaxhimin e procedurave të prokurimit rrezikon që të ketë konflikt në fushat e përgjegjësive të cilat mund të rezultojnë me mangësi në realizimin e procedurave të prokurimit.

Rekomandimi 12 Kryetari, duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të identifikuara dhe të sigurojë që planet dinamike të përputhen me afatet reale të përfundimit të punëve, si dhe të sigurojë se për secilin kontratë janë të hartuara projektet ekzekutive. Po ashtu, duhet të analizohen dhe shqyrtohen shkaqet që kanë ndikuar në ngecjet e projekteve si pasojë e dobësive në proceset e prokurimit dhe të marrë masa për përmirësimin e menaxhimit të tyre.

Çështja 13 - Dobësitë në menaxhimin e kontratave

E gjetura Duket se planet për menaxhimin e kontratave hartoheshin vetëm sa për të përmbushur kërkesat formale/procedurale dhe se nuk azhurnoheshin me informata komform ecurisë së realizimit të kontratave. Përveç kësaj, kemi evidentuar se kryesisht (42 nga 46 kontrata pune) janë menaxhuar vetëm nga një person. Sipas komunës, kjo gjendje ishte rezultat i mungesës së stafit të mjaftueshëm profesional për menaxhimin e kontratave për punë.

Rreziku Numri i madh i kontratave të menaxhuara nga një person paraqet ngarkesë të madhe dhe mund të rezultojë me mos efikasitet/efektivitet në menaxhimin e tyre. Mos azhurnimi i planit për menaxhimin e kontratës pamundëson pasqyrimin e një gjendjeje reale të realizimit të kontratës.

Rekomandimi 13 Kryetari, duhet të sigurojë se planet e menaxhimit të kontratave azhurnohen me kohë në bazë të kryerjes së punëve. Po ashtu në rast të mungesës së stafit të mjaftueshëm, të shqyrtohet edhe mundësia e angazhimit të stafit jashtë njëjësive kërkuese për menaxhimin e kontratave.

Çështja 14 - Certifikimi i pagesës

E gjetura Sipas rregullës financiare nr.01/2013/MF shpenzimi i parasë publike janë të përcaktuar zyrtarët financiar të cilët duhet të bëjnë aprovimin e pagesës në SIMFK. Te pagesa (35,000€) për përkrahje të bizneseve të reja dhe ekzistuese, në mungesë të zyrtarit certifikues, lënda është certifikuar nga zyrtari alternativ i cili njëherit ishte zyrtar zotues.

Rreziku Mangësitë në proceset ekzistuese bien ndesh me rregullat e përcaktuara si dhe reflektojnë në pasiguri të kontrolleve.

Rekomandimi 14 Kryetari, duhet të siguroj se menaxhimi i procesit të shpenzimeve përkatësisht autorizimit të pagesave të bëhen në bazë të kërkesave ligjore, në mënyrë që të parandalohen mundësitë për keq përdorime.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 15 - Tejkalmi i pagesave te kontratat kornizë

E gjetura Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 2/2015 (KRPP) për kontratat publike kornizë, neni 5.1 përcakton përqindjen e mos përputhjes së lejuar nga kontrata e cila nuk mund të jetë më e lartë apo më e ulët se 30%. Në dy kontrata ne identifikuam se kishte tejkalime të theksuara mbi normën 30% të vlerës së lejuar, si:

- Për kontratën publike kornizë “Furnizim me gypa kanalizimi” e datës 02.11.2015, tejkalmi mbi vlerën e lejuar ishte prej 13,906€; dhe
- Për kontratën publike kornizë “Mirëmbajtja e ndriçimit publik” e datës 24.07.2015, tejkalmi mbi vlerën e lejuar ishin 34,358€.

Tejkalmi i pagesave ishte si pasojë e mungesës së kontrolleve adekuate në pozitat përkatëse të proceseve rishikuese.

Rreziku Tejkalmi përtej vlerës së lejuar nga kontrata kornizë, rezulton me pagesa të parregullta dhe mungesë të buxhetit për realizimin e projekteve të parapara.

Rekomandimi 15 Kryetari, duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se para përgatitjes së projekteve bëhen analiza të mjaftueshme lidhur me nevojat për furnizimet/punët e kontraktuara. Në këtë mënyrë do të përmirësohet menaxhimi i kontratave dhe do të shmangen rastet e tejkalimit mbi normën e lejuar +/-30%.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2017 ishte 106,958,052€, ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 269,074€. Stoqet në fund vit ishin 46,793€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Çështja 16 - Mungesa e raporteve të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë

E gjetura Në bazë të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, komuna kishte formuar komisionin për inventarizimin¹⁶ e pasurisë për pjesën e komunës, dhe sektorin e shëndetësisë, ndërsa për sektorin e arsimit nuk ishte formuar komision (për këtë sektor ishte angazhuar komisioni i vitit të kaluar).

- Komisionet kishin hartuar raportet individuale lidhur me inventarizimin e pasurisë së komunës, mirëpo nuk kishin hartuar një raport përmbledhës për pasuritë¹⁷, duke përfshirë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara;
- Komuna, nuk kishte formuar komisionin për vlerësim të pasurive të dëmtuara, vlerësimin e pasurisë jo financiare që duhet të largohet nga përdorimi, apo vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të pasurive; dhe
- Gjatë ekzaminimit fizik të pasurive kemi identifikuar raste të shumta në të cilat mungonin bar-kodet e vendosura për pasuritë që i posedon komuna.

Rreziku Mos formimi i komisioneve për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë, mos hartimi i raportit përmbledhës pa mundëson krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive, duke pamundësuar paraqitjen reale të pasurisë. Gjithashtu mungesa e vendosjes së bar-kodeve në pajisje ka mundësi të mos identifikimit, humbjes apo tjetërsimit të pasurisë që menaxhohet nga ana e komunës.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat ligjore për formimin e komisioneve të cilat do të përfundojnë raportet sipas kërkesave të parapara në rregullore me qëllim që të reflektojë puna e komisioneve në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore. Gjithashtu kryetari duhet të siguroj se e tërë pasuria e komunës identifikohet me barkode.

¹⁶ Komisioni kishte raportuar për punën e përfunduar me datë 21.01.2018.

¹⁷ Sipas nenit 19, pika 4.7 Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PFV në fund të vitit ishin 2,989,592€. Pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e këtyre llogarive e kanë të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 2,447,464€, taksa në biznes 490,597€ dhe të arkëtueshmet nga qiradhënia 51,533€.

Çështja 17 - Mos veprimet për inkasim të llogarive të arkëtueshme

E gjetura Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve të saj, përfshirë të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, taksat në biznes si dhe të hyrave nga qiradhënia, si:

- Vonesa të konsiderueshme në inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë, kryesisht nga viti 2009. Prej tyre pesë raste kishin të bënë me të arkëtueshmet e AKP-së në vlerë 228,386€ për organizatat shoqërore të përfshira në procesin e privatizimit, si dhe në 23 raste tjera kishte vonesa në pagesa nga qytetarë dhe biznese me vlerë prej 71,677€ (borxhe që figuronin nga viti 2008-2016);
- Te taksat në biznes, edhe pse komuna ka dy vite që nuk aplikon taksat (përveç te Bastoret dhe Bankat komerciale), ky veprim nuk i ka inkurajuar bizneset që t'i kryejnë obligimet e tyre ndaj komunës. Te taksat në biznes, mostrat e testuara në vlerë 13,924€ ishin të arkëtueshme të vjetra që nga viti 2008. Veprimi i komunës për inkasim të këtyre borxheve ishte bërë në vitin 2013 kur kishte lëshuar urdhëresë për pagesë, mirëpo nuk ishte arritur qëllimi për inkasimin e tyre; dhe
- Gjatë testimi të kontratës për qiradhënie të objektit komunal, vërejtëm se kishte mos pajtueshmëri në inkasimin e pagesave në pajtim me kushtet e kontratës. Kontrata ishte lidhur me datë 02.02.2017 me vlerë prej 1,000€ me parapagim mujor. Deri në fund të vitit, komuna kishte arkëtuar vetëm 3,000€ duke mos arritur të inkasoj vlerën prej 8,000€, e cila më tej shfaqet si llogari e arkëtueshme.

Me tuje, salldot fillestare të llogarive të arkëtueshme te taksat në biznes ishin nënvlerësuar për 23,652€, ndërsa te shfrytëzimi i pronës publike prej 6,072€. Kjo kishte rrjedhë si pasojë e sistemeve me të cilin menaxhohen këto llogari. Softueri i cili shfrytëzohet për menaxhimin e "taksave në biznes", nuk ofronte raporte analitike për bizneset, ndërsa për menaxhimin e llogarive "shfrytëzimi i pronës publike" nuk kishte softuer, mirëpo ato menaxhohen në Excel, të cilat nuk japin siguri të plotë për të dhënat.

Rreziku Mungesa e veprimeve konkrete për inkasimin e llogarive të arkëtueshme rezulton me rritje të këtyre llogarive, rrezikon që komuna të ketë humbje financiare si dhe rrezikon mos realizimin e projekteve të komunës. Mungesa e softuerëve funksional ka për rrezik saktësinë dhe plotësinë e informatave për të arkëtueshmet dhe shpalosjen e tyre në PFV.

Rekomandimi 17 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duhet të sigurojë procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe inkasimit të tyre. Posedimi i programit efektiv do ta lehtësonte punën dhe mirëmbajtjen e këtyre llogarive.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 121,141€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga komuna. Gjithashtu detyrimet kontingjente me të cilat përballet komuna janë me vlerë prej 2,369,037€.

Çështja 18 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave si dhe raportim jo i plotë i obligimeve

E gjetura Komuna, kishte raportuar¹⁸ në baza mujore në MF obligimet e papaguara, duke mos i përfshirë në raporte edhe obligimet e muajit përkatës. Kjo dukuri është vërejtur me rastin e paraqitjes së obligimeve të raportit të muajit dhjetor.

Ndonëse, ishte bërë përpjekje që të minimizohen vonesat në ekzekutimin e pagesave (63,603€), megjithatë, në disa raste ne identifikuan se ato kishin tejkaluar afatin e lejuar prej 30 ditëve për pagesë.

Rreziku Mos përfshirja e plotë e të gjitha obligimeve në raportet mujore, paraqet pasqyrim jo të drejtë të obligimeve, ndërsa vonesat në pagesa mund të krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues.

Rekomandimi 18 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet sipas rregullës financiare 02/2013.

¹⁸ Rregulla financiare nr.02/2013/mf për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore neni 5 pika 3 "Raporti mujor i obligimeve të papaguara duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur".

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 ka rezultuar me 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna, mirëpo progresi lidhur me zbatimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit ishte në rend dite por nuk ishte diskutuar në Asamblenë Komunale, sipas zotimit të Kryetarit dhënë në raportin e auditimit 2016.

Deri në fund të auditimit tonë, prej 20 rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit 2016, kemi vlerësuar se tetë rekomandime janë zbatuar; nëntë janë në proces të zbatimit dhe tri nuk janë zbatuar. Ndërsa, katër rekomandime të vitit 2015 edhe më tej mbesin të pa zbatuara (ref: Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme).

Çështja 19 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake

E gjetura Edhe pse janë zbatuar kërkesat për të hartuar një plan veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016, progresi lidhur me zbatimin e planit të veprimit nga një grup punues në bashkëpunim me USAID-in nuk ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Si rrjedhojë e menaxhimit jo efektiv të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve, vetëm një pjesë e ulët e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Menaxhmenti i komunës nuk aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve (shih shtojcën II).

Rreziku Përmirësimet e kërkuara të proceseve operationale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar në mos efikasitet të vazhdueshëm përderisa rekomandimet e dhëna nuk adresohen.

Rekomandimi 19 Kryetari, duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka nevojë, të propozohen masat adekuate.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

Procesi i dobët për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të vitit paraprak, ekzekutimi i buxhetit në nivel të ulët për investime kapitale, mungesa e proceseve për menaxhimin e rrezikut dhe kontrolle të dobëta mbi shpenzimet dhe të hyrat janë disa nga dobësitë e identifikuara në qeverisje.

Komuna me kohë kishte përmbushë kërkesën për dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit në MF. Njëra nga çështjet e pyetësorit e cila kishte të bënte me proceset efektive të monitorimit lidhur me progresin e objektivave, konsiderohen si të vendosura nga ana e komunës mirëpo, dëshmitë e ofruara në mbështetje të këtyre konkluzioneve janë të dobëta.

Gjithashtu për vitin 2017 sistemi për menaxhim të rreziqeve nuk ishte vendosur për shkak të mungesës së llogaridhënies për menaxhimin e regjistrit të rreziqeve.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë kryesisht menaxhimin e kontratave të prokurimit, menaxhimin e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme në PFV si rezultat i mos aplikimit të udhëzimeve adekuate.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe një auditor. NJAB kishte hartuar planin strategjik edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë disa auditime për vitin 2017.

NJAB për vitin 2017 kishte planifikuar gjithsej gjashtë auditime (një ishte planifikuar të kryhet sipas kërkesës). NJAB kishte finalizuar të gjitha raportet e planifikuara.

Çështja 20 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

E gjetura Komiteti i auditimit (KA) nuk kishte qenë funksional gjatë vitit 2017. Në prill 2017 kishte skaduar mandati i KA-së paraprak, i cili kishte mbajtur vetëm një takim, ndërsa në qershor 2017 ishte themeluar KA i ri i cili deri në fund vit nuk ka mbajtur asnjë takim. Një nga shkaqet e mos mbajtjes së takimeve ishte situata politike me rastin e zgjedhjeve lokale pasi që një nga anëtarët e KA-së ishte kandidat për kryetar të komunës.

Rreziku Mos funksionimi i KA-së shkakton mungesën e sigurisë dhe këshillave që i ofrohen menaxhmentit në lidhje me rreziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit. Në veçanti kjo mund të rezultojë me mangësi në realizimin e planeve të NJAB-së dhe zvogëlon sigurinë se rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar.

Rekomandimi 20 Kryetari në bashkëpunim me kryesuesin e KA-së duhet të analizojnë situatën aktuale dhe të sigurojë funksionimin normal të aktiviteteve të komitetit komfor kërkesave ligjore me qëllim të arritjes së objektivave të themelimit të KA-së.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 21 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Rrjedhimisht pasqyrat financiare vjetore kanë rezultuar me disa pasaktësi dhe gabime. Trajtimi i disa zërave nuk ka qenë adekuat, si të klasifikimi i shpenzimeve në PFV, bartja e saldove fillestare të llogaritë e arkëtueshme, si dhe regjistrat e paplota të pasurive.

Sipas rregullave të MFK-së, komuna duhet të ketë një sistem për menaxhim të rreziqeve. Megjithatë, për vitin 2017 ky sistem nuk ishte vendosur për shkak të mungesës së llogaridhënies për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e llogaridhënies dhe raportimi financiar duhet të forcohen për të përkrahur efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, saldot fillestare duhet të rishikohen dhe verifikohen në mënyrë që informacioni financiar të jetë i krahasueshëm dhe i plotë në funksion të konsistencës dhe mbi të gjitha ta përkrahë vendimmarrjen.

Rekomandimi 21 Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe

gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

të përfshihet menjëherë pas opinionit;

të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime.		Në proces të zbatimit, pasi ende për projektin në fjalë nuk kanë përfunduar punët, gjithashtu në vitin 2017 kemi regjistra të paplota të pasurive.	
2. Qeverisja - Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar dhe një monitorim rigoroz i këtij procesi. Sugjerojmë që edhe përfaqësues nga Kuvendi Komunal të jetë pjesë e këtij procesi		Në proces të zbatimit pasi jo të gjitha rekomandimet janë duke u zbatuar sipas planit të veprimit.	
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një planifikim i mirëfilltë i projekteve kapitale në mënyrë që projektet të realizohen ashtu siç buxhetohen në tabelat e buxhetit.		Në proces të zbatimit pasi jo të gjitha projektet zbatohen në bazë të planifikimit. Shpenzimet për investimet kapitale ishin realizuar vetëm 75%.	
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për gjetjet e auditimit për rastet ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse dështimet kanë ndodhur dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme.		Përkundër përmirësimit të menaxhimit të projekteve, edhe gjatë vitit 2017 ka raste kur mungonte projekti ekzekutiv.	

3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Prokurimi	Kryetari duhet të inicioj shqyrtimin e rastit dhe të siguroj se paramasat, paralogaritë dhe analizat tjera teknike për projektet që do të tenderohen janë kryer në mënyrë të hollësishme dhe se devijimet nga projektet e hartuara do të jenë minimale. Pas shqyrtimit të rastit, ndaj personave përgjegjës të inicioj masa adekuate të përgjegjësisë dhe të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të LPP dhe ligjeve tjera relevante. Gjithashtu, të siguroj se në të ardhmen nuk do të përsëriten praktikatat e ngjashme.	Po		
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të bëjë pagesa para se të konfirmohet se punimet apo shërbimet janë kryer. Pagesat duhet të jenë të dokumentuara me fatura dhe raporte të konfirmuara për pranimin e punëve/shërbimeve. Aspekti i mbikëqyrjes dhe raportimit të detyrimeve që dalin nga këto marrëveshje, duhet të jetë subjekt i shqyrtimeve të rregullta nga menaxhmenti i komunës. Për të eliminuar rrezikun për dështimin e këtyre marrëveshjeve, ne do të sugjeronim që praktikatat e tilla të pagesave të ndërpriten.		Në proces të zbatimit, edhe gjatë auditimit të vitit 2017 punët nuk kishin përfunduar.	
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të rishikoj kontratat për shërbime të veçanta si dhe të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për shërbime të veçanta dhe jo për pozita të zakonshme			Nuk janë marrë masa.
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë dhe të mbajë një evidencë për objektet komerciale të cilat nuk zhvillojnë afarizëm.			Nuk janë marrë masa.

3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se do të bëhet një analizë më gjithëpërfshirëse e sipërfaqeve potenciale të tokave për t'u dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, me qëllim të maksimizimit të përfitimit edhe të komunës dhe të qytetarëve.		Në proces të zbatimit, nuk ka një listë gjithëpërfshirëse mirëpo me vendime të Kuvendit Komunal përcaktohen pronat të cilat jepen në shfrytëzim të përkohshëm.	
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli – Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të sigurojë që të respektohen të gjitha procedurat e regjistrimit të pasurive komunale në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhim të pasurive.			Nuk janë marrë masa.
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli – Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të sigurojë iniciimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Çështja e pagesave si shpenzim në shumën prej 204,000€ duhet të korrigjohet me Thesarin dhe e njëjta të regjistrohet në kodin e avanseve. Korrigjimet e regjistrimeve kontabël duhet të bëhen edhe te pasuritë dhe llogaritë e arkëtueshme.		Në proces të zbatimit, çështja e pagesave nuk është korrigjuar dhe projekti nuk ka përfunduar në tërësi. Korrigjimet për pasurinë dhe llogaritë e arkëtueshme ishin kryer.	
1. Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndajPFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Në proces të zbatimit, pasi kontrollet zbatohen, mirëpo ende ka mangësi ne regjistra te pasurisë (regjistra te paplota), llogarive të arkëtueshme.	

2. Qeverisja - Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioritetëve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.		Në proces të zbatimit, pasi ende ka rekomandime të cilat nuk janë zbatuar sipas planit të veprimit.	
2. Qeverisja - Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për zëra të caktuar në raportimin financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme.		Në proces të zbatimit. Edhe në vitin 2017 pasqyrat financiare vjetore kanë rezultuar me disa pasaktësi për shkak të dobësive në kontrollet menaxheriale.	
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.		Në proces të zbatimit. Realizimi i investimeve kapitale nuk ishte në nivelin e pritur, vetëm 75% e buxhetit ishte shpenzuar.	
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë siç kërkohet me udhëzimin administrativ. Po ashtu, duhet të sigurojë se barazimet ndër departamentale kryhen në baza të rregullta mujore dhe të shqyrtoj mundësinë e mbledhjes së borxheve të cilat janë grumbulluar.			Nuk janë marrë masa.

3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Pagat dhe mëditjet	Kryetari të siguroj që rekrutimi të bëhet në bazë të planifikimeve paraprake në mënyrë që të ketë mjete të mjaftueshme para fillimit të procedurave të rekrutimit.	Po		
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj që pagesat të cilat nuk ishin paraparë në kontratë, të mos i faturohen më komunës. Në rastin konkret, komuna duhet të kërkoj rimbursimin e mjeteve nga OE për shumën e paguar, si dhe të forcohen kontrollet e çertifikimit që të mos aprovohen pagesat e pa bazuara në ligje dhe rregulloret financiare.			Nuk janë marrë masa.
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të forcoj kontrollet financiare dhe të sigurojë që pagesat bëhen sipas kodeve përkatëse të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit.			Nuk janë marrë masa.
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.	Po		
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj që kontratat nënshkruhen vetëm në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit, se dhe asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen nga ana e OE.	Po		

3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se komuna ka bërë specifikime të sakta për llojin dhe nevojën e shërbimeve, para se të bëj përzgjedhjen e operatorëve, dhe të siguroj se të gjithë artikujt e kontraktuar të furnizohen, duke përfshirë edhe artikujt me çmime jo normalisht të ulëta.	Po		
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se janë përmbushur të gjitha kriteret e parapara për subvencionim të aplikantëve, në mënyrë që fondet publike të shpenzohen sipas rregulloreve të përcaktuara.	Po		
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj aplikimin e kërkesave ligjore për mbajtjen e tatimit në burim në rastet e pagesave të qirasë nga komuna.	Po		
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UA i KRPP nr. 1/2014 Për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Po ashtu, pasi që komuna veç e ka kontraktuar këtë shërbim, të përdor të njëjtin për të aplikuar një koncept më ekonomik të administrimit të procesit dhe të jetë në pajtim me kërkesat e rregulloreve.		Në proces të zbatimit. Komuna ka përmirësuar menaxhimin e ekzekutimit të kontratave në vitin 2017, mirëpo edhe me tutje janë identifikuar raste kur nuk janë hartuar projekte për menaxhimin e tyre.	

3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e pagesave të situacioneve të ardhshme për projektet në vazhdim, si dhe projektet e reja, të aplikohet libri ndërtimor dhe i njëjti të harmonizohet me situacionet për të verifikuar saktësinë e punimeve të kryera në një të anë, dhe pagesave në anën tjetër. Menaxherëve të projekteve t'u qartësohet se aktivitetet e ardhshme duhet të jenë në pajtim me Ligjin e ndërtimit nr. 04/L - 110, dhe UA 15/2013 i MMPH, mbi kushtet për mbajtjen e ditarit dhe librit ndërtimor.		Në proces të zbatimit. Në disa raste mungon libri ndërtimor me rastin e pagesave të situacioneve.	
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se njësitë kërkuese të prokurimit, para se të iniciojnë procedurat, bëjnë një analizë të detajuar të vlerësimit të nevojave, duke siguruar se në specifikacionin teknik nuk përfshihen pozicione të cilat janë të panevojshme.	Po		
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që të respektohen të gjitha procedurat e regjistrimit dhe mirëmbajtjes të pasurive komunale në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhim të pasurive.			Nuk janë marrë masa.
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur kontrole të përmirësuara dhe më efektive, në mënyrë që evidentimi dhe pasqyrimi i saldove të llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë.		Në proces të zbatimit. Ende ka raste kur saldot e llogarive të arkëtueshme nuk pasqyronin saktë gjendjet e tyre.	
3. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli - Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se ekzekutimi i pagesave të bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj dhe rregulloret shoqëruese.		Në zbatim, me gjithë përpjekjet ka ende raste të vonësive në pagesa.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRAN	
92 Nr. / Br	651/18
Nr. i Eq. / Br. i	
Data: / Datum	15.05.2018
VUSHTRRI - VUÇITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Vushtrrisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Data: / Datum 15.05.2018			
04	400	679	1

z. Xhafer Tahiri.....
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Data: 15. Maj, 2018, Prishtinë,

